

Syllabusi i lëndës:

Lënda: Usulul Fikh- Bazat e së Drejtës Islame

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 310

Fondi i orëve: 2+2

Semestri: VI-të

Viti akademik: 2025/2026

Semestri: -VI-të

Mësimdhënësi: Mr. Ajni Sinani

Përshkrim i shkurtër i lëndës:

Lënda Usul Fikh merret me bazat dhe metodologjinë mbi të cilat është ngritur Jurisprudenca Islame. Kjo lëndë studion-analizon bazat e së Jurisprudences Islame dhe rregullat e specifikat e çdo njërës prej tyre. Po ashtu zbërthehen metodologjitë përkatëse të çdo argumenti dhe mënyra e përfitimit-nxjerrjes së normave juridike prej tyre. E tëra kjo bëhet në dritën e metodologjisë që kanë vendosur dijetarët e mëdhenj-themeluesit e shkollave juridike Islame. Kjo lëndë aftëson studentët të kuptojnë para së gjithash thelbin dhe shpirtin e së Drejtës Islame si dhe synimet sublime të saj.

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë rreth shkencës së Usuli Fikhut, e cila merret me bazat dhe metodologjinë mbi të cilat është ngritur jurisprudenca Islame. Dhe atë duke studiuar-analizuar bazat e së drejtës së Sheriatit detajisht dhe rregullat dhe specifikat e çdo njërës prej tyre. Po ashtu zbërthehen metodologjitë përkatëse të çdo argumenti dhe mënyrën e përfitimit-nxjerrjes së normave juridike prej tyre. Të gjitha këto në dritën e metodologjisë që kanë vendosur themeluesit e shkollave juridike Islame. Dhe me tërë këtë arrihet fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës dhe krahasimit në aspektin e vlerësimit të argumenteve dhe klasifikimit të tyre bazuar në metodologjinë e kësaj shkence. I jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, të kuptoj se çështjet diskutabile në mes shkollave juridike janë si rrjedhojë e metodologjisë përkatëse të çdo shkolle, dhe i mundëson të bëjë krahasime të përgjithshme mes tyre. Po ashtu e pajis me mundësinë e qasjes ndaj risive bashkëkohore dhe formon një pasqyrim rreth tyre duke kuptuar qëndrimet e juristëve Islam përkitazi me to.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj bazamentet e jurisprudencës Islame.

Të krahasoj dhe të kategorizoj çdo njërin prej tyre në pozitën e vet përkatëse.

Të diskutoj rreth kushteve dhe specifikave të çdo njëres nga këto baza.

Të përshkruaj metodologjitë e nxjerrjes së normave juridike nga burimet e tyre.

Të kuptoj të gjitha kompetencat e fituara me argumentet përkatëse.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të shfrytëzohen pajisjet e projektorëve për prezantimin e njohurive në formë të slljadeve me programin Power Point. Do të kërkohen punime seminarike dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore. Në bazë të nevojës do të zhvillohen përsëritje të rregullta të njësive paraprake. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Njoftim me natyrën shkencës së Usuli Fikhut dhe rëndësinë që e ka.

Shtjellim i syllabusit të lëndës për këtë semestër, dhe metodës e cila do të aplikohet. PËRKUFIZIMI I SHKENCËS SË USULI FIKHUT. Shtjellim i nocioneve të definicionit el-Usul, el-Fikh. Dallimet mes dijetarëve të shkencës së Usuli Fikhut në definimin e tij. Shpjegimi i përkufizimit.

Literatura: Taxhedin BISLIMI, Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut f. 6-13 *(Ky libër në vazhdim do të jetë literaturë bazë e zhvillimit të ligjëratave, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).*

Java e dytë: ZANAFILLA DHE ZHVILLIMI I USULI FIKHUT. Legjislacioni (Sheriati) në periudhën e Pejgamberit s.a.v.s. Periudha e sahabëve. Periudha e Imamëve muxhdehinë. Imam Shafi'iu dhe përpilimi i Usuli Fikhut.

SHKOLLAT DHE METODOLOGJITË E PËRPILIMIT NË USULI FIKH. Shkolla e Shafi'itëve ose mutekeliminëve. Shkolla (metoda) e Hanefijve. Metoda e dijetarëve të mëvonshëm. Dobitë e Usuli Fikhut.

Literatura: (f. 15- 27)

Java e tretë: BURIMET E LEGJISLACIONIT ISLAM. Ndarja e burimeve të legjislacionit. Aspektet e ndarjes së këtyre burimeve. Burimet e njëzëshme të legjislacionit. Hyrje në definicionin e Kuranit. Përsëritje të materies nga ligjëratat paraprake.

PËRKUFIZIMI I KURANIT. Shpjegimi i përkufizimit. Përkthimi i Kuranit, norma dhe dobitë. Mrekullia e Kuranit në shprehje dhe kuptim. Leximi i vetmuar, norma dhe argumentueshmëria e tij. Frytet praktike të këtij qëndrimi.

Literatura: (f. 35-46).

Java e katërt: MREKULLIA E KURANIT DHE METODOLOGJIA E TIJ. Argumentueshmëria e Kuranit. Aspektet dhe lëmenjtë e mrekullisë së Kuranit. Dispozitat e Kuranit dhe llojet e tyre. Metodika e sqarimit të dispozitave. Përsëritje nga ligjëratat e kaluara.

Literatura: (f. 47-58).

Java e pestë: SUNNETI- BURIMI I DYTË I SHERIATIT. Definimi i Sunnetit nga aspekti etimologjik dhe terminologjik. Ndarja e Sunnetit nga aspekti i ligjdhënsisë. Gjendjet kur nuk merret tradita profetike për argument. Gërshetimi i disa funksioneve në personalitetin e të Dërguarit s.a.v.s dhe ndikimi i saj në ligjdhënësi. ARGUMENTUESHMËRIA E SUNNETIT DHE NDARJA E TIJ PËR NGATransmetimi. Argumentet nga Kurani, konsensusit, dhe hadithi. Ndarja e Sunnetit sipas zingjirit të transmetuesve, dhe fryti i ndarjes. Kushtet e veprimit me hadithin Ahad. Pozita e Sunnetit ndaj Kuranit.

Literatura: (f. 58-76).

Java e gjashtë: IXHMAI-KONSENSUSI, BURIMI I TRETË LIGJDHËNËS Përkufizimi i Ixhmait. Shtyllat e Ixhmait. Kushtet e Ixhmait. Argumentueshmëria e Ixhmait. Mundësia e formimit të Ixhmait dhe implementimit të tij në praktikë. Dispozita , rangu dhe llojet e tij. Organizimi i testit të parë duke i ndarë studentët në dy grupe.

Literatura: (f. 98-105).

Java e shtatë: ANALOGJIA- KIJASI, BURIMI I KATËRTË I LEGJISLACIONIT Kushtet e motivit. Argumentueshmëria e Kijasit-Analogjisë. Argumentet nga Sunneti rreth Kijasit. Fushëveprimi i hulumtimit mbi motivin. Llojet e motivit. Mënyrat e njohjes së motivit Diskutim me studentët rreth rezultateve të pritura dhe atyre të arritura.

Literatura: (f. 106-115).

Java e tetë: ANALOGJIA- KIJASI, BURIMI I KATËRTË I LEGJISLACIONIT Kushtet e motivit. Argumentueshmëria e Kijasit-Analogjisë. Argumentet nga Sunneti rreth Kijasit. Fushëveprimi i hulumtimit mbi motivin. Llojet e motivit. Mënyrat e njohjes së motivit.

Literatura: (f. 115-127)

Java e nëntë: BURIMET JO TË NJËZËSHME TË SHERIATIT. ISTISLAHI - REZONIMI JURIDIK NË BAZË TË INTERESIT TË PËRGJITHSHËM. Përkufizimi i tij dhe llojet e tij. Kushtet e të argumentuarit me të. Qëndrimi i katër medhhebeve ndaj këtij burimi me shembuj konkret të normave të nxjerrura nga ky burim.

Literatura: (f. 128-134).

Java e dhjetë: ISTIHSANI- PREFERIMI I REZONIMIT JURIDIK Përkufizimi i Istihsanit, argumentueshmëria dhe llojet e tij. Ndarja e Istihsanit te hanefijtë. URFI-TRADITA SI BURIM LEGJISLATIV. Përkufizimi i Traditës, llojet dhe dispozita e saj. Dallimi në mes Traditës dhe Ixhmait. Argumentueshmëria e Traditës. Ndryshimi i dispozitës me ndryshimin e Traditës.

Literatura: (f. 135-146)

Java e njëmbëdhjetë: ISTIS'HABI- REZONIMI JURIDIK I BAZUAR NË GJENDJEN E MËHERSHME. Përkufizimi i Istis'habit dhe llojet e tij. Norma e Istishabit dhe pozita e tij. Mospajtimi në argmuntueshmërinë e tij dhe fryti i tij. Disa rregulla të sheriatit që janë ngritur mbi Istis'habin. Përsëritje të materies nga ligjëratat paraprake. Organizimi i testit të dytë duke i ndarë studentët në dy grupe.

Literatura: (f. 146-152)

Java e dymbëdhjetë: SHERIATI I ATYRE QË ISHIN PARA NESH. MEDHHEBI I SAHABIUT. Çfarë kemi për qëllim me sheriatin e atyre që ishin para nesh? Qëndrimet e juristëve Islam ndaj këtij burimi legjislativ dhe frytet e tyre. Medhhebi i sahabiut definicioni dhe argmunetueshmëria e tij. SEDDU DHERAI- REZONIMI JURIDIK MBI MASAT PREVENTIVE. VEPRAT E BANORËVE TË MEDINES. Definimi i këtyre burimeve jo unanime dhe mendimet e juristëve Islam rreth tyre.. Diskutim me studentë rreth rezultateve të pritura dhe atyre të arritura të testit.

Literatura: (f. 152- 160)

Java e trembëdhjetë: MËNYRA E NXJERRJES SË DISPOZITAVE NGA ARGUMENTET TEKSTUALE. . Hyrje dhe njoftim me natyrën e këtij kapitulli- elmushterek-fjalët ambivalente si mostër. RENDITJA E CITATEVE NGA ASPEKTI I QARTËSISË. Tekstet me kuptim të qartë, radhitja e tyre dhe normat që nxirren nga çdo njëri prej tyre RENDITJA E CITATEVE NGA ASPEKTI I PAQARTËSISË. Tekstet jo të qarta dhe kategorizimi i tyre, dhe normat që nxirren nga çdo njëri prej tyre. Përsëritje nga ligjëratat e kaluara.

Literatura: (f.271-286).

Java e katërbëdhjetë: IXHTIHADI- KONTRIBUTI INTELEKTUAL I DIJETARËVE NË NXJERRJEN E NORMAVE. Baza juridike e ixhtihadit. Fushëveprimi i Ixhtihadit dhe ku ai nuk lejohet. Kushtet e ixhtihadit dhe dispozita e tij. Përpjestimi i Ixhtihadit dhe rezultati i tij. Të ndryshuarit e ixhtihadit dhe anulimi i tij me një tjetër.

TAKLIDI- PASIMI DHE FETVAJA- REZONIMI JURIDIK. Përkufizimi i taklidit dhe fushëveprimi i tij. Taklidi në çështje dytësore. Fetvaja, fushëveprimi dhe dallimi mes saj dhe gjykimit. Llojet e Ixhtihadit.

Literatura: (f 77-97).

Java e pesëmbëdhjetë: Përmbyllje SYNIMET SUBLIME TË SË DREJTËS ISLAME. Qëllimi i përgjithshëm i Legjislacionit hyjnor. Llojet e objektivave dhe radhitja e tyre. Argumentimi për radhitjen e tyre. Ndërtimi i dispozitave të sheriatit mbi këto objektiva.

Literatura: (f. 309-317)

Literatura obliguese:

1. Taxhedin BISLIMI, Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut; Shkup 2003.

Literartura shtesë dhe bibliografia:

1. *Flamur Sofiu; Usuli Fikhu -Bazat dhe metodologjia e jurisprudencës Islame, Prishtinë, 2000*

2. El-xhevanibu Et-terbevijetu fi Usulil Fikhil Islamij, prof. dr. El-Buga, Mustafa Dib, Irbid- Jordani 2006.

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrja: 10 pikë

Punimi seminarik dhe aktiviteti gjatë orës: 20 pikë

Vlerësimi i testit të parë: 30

Provimi final: 40 pikë

Gjithsej: 100 pikë

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100% -shkëlqyeshëm

9= 80 – 89 - shumë mirë

8=70 – 79 - mirë

7=60 – 69 - mjaftueshëm

6=50 – 59 - pamjaftueshëm

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime (teorike)	1	15	15
Përgatitja për kollokfium	2	5	10
Konsultime	1	5	6
Testi, punë sem.	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Mësimi individual (bibl. ose shtëpi)	1	15	15
Përg. për provim final	3	5	15
Koha e vlerësimit	2	2	4
Projektet, prezantimet	1	10	10
Totali		15 javë	150 orë